



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 704/24 Dt. 12.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas shqyrtimit të kërkesës 01-030 nr. 145782 të datës 04.11.2024, të Shoqatës “Gratë burrnesha”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 145782 të datës 04.11.2024, të Shoqatës “Gratë burrnesha”, gratë të prekura nga kanceri, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve të transportit për realizimin e vizitës të kësaj Shoqate në varrezat e dëshmorëve të familjes Jashari në Prekaz, gjatë muajit nëntor 2024, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve rreth këtij udhëtimi (transporti, ushqimi, etj.), lejohen mjetet financiare në shumën prej 400 € (katërqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Shoqatës “Gratë burrnesha”,
 - Arkivës së Kryetarit.